



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Autoriteti i Konkurrencës
Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority



Vendimi Nr. K-10/25

Datë: 22.04.2025

Duke u bazuar në nenet 11, 13, 15, 16, 17, 18, 26, 27 dhe neni 55 nën paragrafi 1.5, të Ligjit Nr. 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2023, Për Mënyrën e Paraqitjes së Kërkesës 01/2023 Për Mënyrën e Përcaktimit të Tregut Relevant, Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës i Republikës së Kosovës në mbledhjen e datës 22.04.2025, mori këtë;

V E N D I M

I. LEJOHET përqendrimi lidhur me marrjen e kontrollit të përbashkët nga GEN dhe SEL nëpërmjet blerjes dhe marrjes së kontrollit të 100% të aksioneve në Gorenjske elektrane, proizvodnja elektrika, d.o.o. (blerësi) mbi Elektro Gorenjska (shitësi).

II. Parashtruesi i njoftimit për Përqendrim, obligohet të paguaj taksën administrative prej 1,000.00 €, me shkronja (njëmijë euro), dhe Vendimin për Realizimin e Përqendrimit, në përputhje me nenin 55, paragrafi 1.5, të ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe neni 24 të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2023, bëhet kundrejt pagesës në vlerë prej 6,000.00 € me shkronja (gjashtë mijë Euro).

Arsyetim

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës, me datë; 07.03.2025, ka pranuar kërkesën me Nr. Prot. 131/25-01/H, lidhur me marrjen e kontrollit të përbashkët nga GEN dhe SEL nëpërmjet blerjes dhe marrjes së kontrollit të 100% të aksioneve në Gorenjske elektrane, proizvodnja elektrika, d.o.o. (blerësi) mbi Elektro Gorenjska (shitësi).

Palët në Përqendrim:

GEN energjia d.o.o (GEN)., Veprimtarit e shoqërive holding, tregtia me shumicë e energjisë elektrike, me adrese të regjistruar: Vrbina 17, 8270 Krško, Slovenija, e regjistruar në regjistrin e biznesit të Sllovenisë me numrin e regjistrimit: 16466113000, Lloji i Shoqërisë; Joint Stock Company.

SAVSKE ELEKTRARNE LJUBLJANA d.o.o (SEL), Aktiviteti i shoqërisë, prodhimi i energjisë elektrike nga burime të rinovueshme, me adrese; Gorenjska cesta 46, 1215 Medvode, me numër të biznesit; 42903398, Lloji i shoqërisë; Shoqëri aksionare.

ELEKTRO GORENJSKA, podjetje za distribucijo električne energije, d.d., Aktiviteti i shoqërisë, shpërndarja e energjisë elektrike, me adrese; Ulica Mirka Vadnova 3A 4000 Kranj, me numër të biznesit; 5175348000, Lloji i shoqërisë; Shoqëri aksionare.

GORENJSKE ELEKTRARNE, proizvodnja elektrike, d.o.o., Aktiviteti i shoqërisë; prodhimi i energjisë elektrike nga burime të rinovueshme, me adrese; Stara cesta 3 4000 Kranj, me numër të biznesit; 40045487, Lloji i shoqërisë; Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara.

Procedurat e ndjekura:

1. Vërtetimi për Kërkesën e Dorëzuar me datë: 19.03.2025
2. Njoftimi për realizimin e përqendrimit në web faqen e AKRK-së me: datë 20.03.2025
3. Palët kanë nënshkruar Marrëveshjen me datë: 06.01.2025 Kompania Elektro Gorenjska, si shitës, shet 100% të kuotave të saj në Gorenjske elektrarne të blerësit GEN dhe SEL

Baza Ligjore dhe akti i Përqendrimit:

Sipas nenit 13, të Ligjit 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës, përmbushet detyrimi për të bërë njoftimin e Përqendrimit pasi që:

- I. Qarkullimi i kombinuar i palëve në tregun ndërkombëtarë e kalon shumën 20,000,000 Euro.
- II. Qarkullimi i një pale në Përqendrim e kalon shumën 1,000,000 Euro.

Struktura e Përqendrimit:

Kompanitë **GEN energjia d.o.o (GEN)**, **Savske elektrarne Ljubljana (SEL)** dhe **Elektro Gorenjska, d.o.o** (ne vijim: Elektro Gorenjska) kanë nënshkruar një marrëveshje për shitblerjen e kuotave të biznesit në kompaninë **GORENJSKE ELEKTRARNE, proizvodnja elektrika, d.o.o.** me datë: 06.01.2025.

Sipas kësaj marrëveshjeje, kompania Elektro Gorenjska, si shitës, shet 100% aksionet e saj në Gorenjska elektrarne te blerësi GEN dhe SEL,

Blerësi GEN është kompania mëmë e Grupit GEN, dhe një nga aktivitetet e saj kryesore është menaxhimi i subjekteve të pavarura ligjore ku ka ndikim dominues. Qëllimi i përbashkët i kompanive brenda Grupit GEN është të sigurojnë furnizim të besueshëm, të sigurt, të qëndrueshëm dhe konkurrues me energji elektrike nga burime të rinovueshme dhe të qëndrueshme, ndërsa Blerësi tjetër SEL, është pjesë e Grupit GEN, dhe aktiviteti i tij kryesore ekonomik është prodhimi i energjisë elektrike në hidrocentrale. Përveq kësaj, SEL ofron edhe shërbime të operimit dhe mirëmbajtjes për sigurimin e funksionimit të pandërprerë të hidrocentraleve, duke përfshirë mirëmbajtjen e pajisjeve elektrike, mekanike dhe të telekomunikacionit, si dhe të infrastrukturës ndërtimore.

Tregjet ku parashikojmë që ky transaksion do të ketë ndikim janë:

- Prodhimi, shitja me shumicë dhe shitja me pakicë e energjisë elektrike,
- Inxhinieria dhe shitja e paneleve diellore (PVPP)

Ndërsa Grupi GEN operon edhe në tregje të huaja, Gorenjske elektrarne operon ekskluzivisht në tregun sloven. Me këtë transaksion, GEN synon të zgjerojë portofolin e saj të prodhimit, me qëllim sigurimin e furnizimit të qëndrueshëm dhe të besueshëm me energjinë elektrike, si dhe optimizmin e prodhimit brenda Grupit GEN. Kjo do ti mundësonte GEN-it të përfshinte energjinë e prodhuar nga Gorenjske elektrarne në portofolin e saj, duke rritur kështu pjesëmarrjen e saj në burime të rinovueshme të energjisë, GEN synon të arrijë një funksionim të qëndrueshëm dhe të besueshëm të të gjitha centraleve të saj dhe të sigurojë furnizimin e tregut me energji elektrike.

Prandaj, ky transaksion përben një përqendrim në kuptimin e nenit 11 të Ligjit për Konkurrencën dhe plotëson pragjet e përcaktuara në nenin 13 të Ligjit për Konkurrencën, dhe për këtë arsyeje është i njoftueshëm në Autoritetin e Konkurrencës të Kosovës.

Tregu përkatës,

Tregu i produktit – tregu përkatës i produktit mund të përkufizohet si treg i energjisë elektrike veçanërisht prodhimin e energjisë elektrike.

Tregu gjeografik- lidhur me shtrirjen gjeografike relevante për Transaksionin, tregu gjeografik përkufizohet si treg ndërkombëtar duke përfshirë edhe Republikën e Kosovës, tregu gjeografik mund të mbetet i hapur, pasi që transaksioni nuk do të ketë efekte negative në konkurrencën në Kosovë, pasi që transaksioni po zhvillohet jashtë Kosovës dhe nuk ka efekte në territorin e saj.

Analiza e konkurrencës

Në bazë të Ligjit 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës është përmbushur kriteri ligjor për paraqitje të Njoftimit për Përqendrim. Transaksioni zhvillohet jashtë Kosovës nuk do të ketë efekte negative në konkurrencën brenda tregut të Kosovës. Konkretisht transaksioni

nuk do të dërgojë në krijimin ose forcimin e pozitës dominuese në treg, nuk do të rezultojë në parandalimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës.

Efektet e konkurrencës në tregun përkatës nga transaksioni i realizuar

Efektet e këtij transaksioni do të ndodhin në Slloveni. Duke pasur parasysh faktin se asnjëra nga kompanitë nuk është aktive në Kosovë, nuk do të ketë efekte në asnjë segment të tregut të energjisë elektrike në Kosovë. Kjo tregon se ndryshimet në strukturën financiare apo pronësore të objektivit nuk do të çonin në ndonjë ndryshim apo efekt në strukturën apo konkurrencën e tregut kosovar. GEN synon të zgjeroj portofolin e saj të prodhimit me synimin për furnizim të sigurt dhe të besueshëm me energji elektrike dhe optimizimin e prodhimit të grupit GEN. Portofoli aktual i GEN bazohet në burimet e mëposhtme të qëndrueshme dhe të rinovueshme të energjisë: energjia bërthamore, energjia hidrike, energjia diellore.

Qëllimi i zgjerimit të portofolit të prodhimit mund të arrihet përmes Përqendrimit të propozuar, GEN do të zgjeronte portofolin e tij me energjinë në dispozicion dhe energjinë elektrike të prodhuar nga Gorenjske elektrarne dhe do të rriste pjesën e burimeve të rinovueshme të energjisë. Blerisi -GEN dhe SEL do të financojnë blerjen nga fondet e veta të GEN Group- nuk do të përdoren burime të jashtme. Ky përqendrim nuk do të ndikojë në interesat e konsumatorëve në Kosovë. Kërkesa për Përqendrim do të bëhet në Slloveni, Kosovë, Mal të Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Serbi.

Komisioni i Konkurrencës, ka konstatuar se përqendrimi i njoftuar bie në fushëveprimin e Ligjit, pasi i plotëson kërkesat e nenit 13 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 nenit 15 dhe nenit 16 të Ligjit Nr. 08/L-056, Për Mbrojtjen e Konkurrencës, andaj ka vlerësuar se si i tillë, referuar nga “Njoftimi” nuk do të paraqesë efekte negative për konkurrencën, sepse nuk do të rezultojë në kufizim të konkurrencës, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese në tregun përkatës, në Republikën e Kosovës.

Shënim:

Çdo formë e shtrembërimit të konkurrencës, respektivisht sjellje anti-konkurruese, do të jetë, nën monitorimin e Autoritetit të Konkurrencës të Republikës së Kosovës.

Kërkesa për Përqendrim, merr epilogun si në dispozitiv të këtij VENDIMI.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI**



Kaltrina Sela
Nënkryetare

Natije Osdautaj
Anëtare

Salihe Gashi Loku
Anëtare

III. Me këtë Vendim, të njoftohen:

- Palët
- Arkiva